

**STATUT DHE AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"DAMOS" SHPK**



Ne Bilisht, sot me date **27/07/2023** ne respektim te kerkesave te ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, u hartua statuti dhe akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me ortake themelues:

-Znj. Klodiana Krali shtetase Shqiptare, e bija e Zoifori lindur me 09/10/1981 ne Hociht, ALB, dhe banues ne H o c i s h t , Satrivac, Nd.53; H.1; 7009; Devoll, Shqiperi, identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. 034507555, Ieshuar ne date 25.07.2019 e vlefshme deri me date 24.07.2029 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

-Z. ILIA DAMOS shtetas Shqiptar i biri i Vangjel lindur me 09/01/1947 ne Greqi, dhe banues ne L9 Rr.Kiço Greço; Nd. P.32; H. H.3; Ap. Ap.31; Korce; 7001, Shqiperi, identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. 035741267, Ieshuar ne date 30.01.2020 e vlefshme deri me date 29.01.2030 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

te cilet hartojne kete statut te shoqerise "DAMOS" shpk,mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:


KREU I

THEMELIMI - EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

NENI 1

Themelimi

1.1 Shoqeria "DAMOS" shpk eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga 2 ortake te shoqerise, te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne



personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

NENI 2

Emertimi

2.1 Shoqeria tregtare emertohet "**DAMOS**" shpk.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e shoqerise "DAMOS" shpk eshte ne adresen: Rruga Hociisht-Bilisht, ZK 1955, Nr Pasurie 532/2 , Devoll, Shqiperi.

3.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë apo të themelojë dhe/ose të mbyllë një degë dhe/ose zyrë përfaqësimi brenda Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj..

NENI 4

Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise ""DAMOS" shpk eshte e pakufizuar

NENI 5


Objekti

5.1 Shoqeria "DAMOS" shpk ka per objekt : Fason, Sherbime te ndryshme, Prodhim dhe qepje veshjesh te te gjitha llojeve, paketim te tyre, si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tjera që konsiderohen të ndërlidhura apo ndihmëse për arritjen e objektit të mësipërm. Për më tepër, Shoqëria mund të hyjë në cdo transaksion i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të mësipërm.

NENI 6

AKTET E SHOQËRISË

6.1 Të gjitha dokumentet e nxjerra nga Shoqëria dhe që i drejtohen palëve të treta, si





letra, fatura, njoftime, lajmërime etj, duhet të përmbajnë emrin e shoqërisë dhe fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet "SH.P.K." dhe numrin unik të identifikimit (NUIS).

KREU II

KAPITALI, CERTIFIKATA E KUOTËS ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 7

Kapitali Themeltar

7.1 Kapitali Themeltar i shoqërisë është **500,000** (peseqind mijë) Leke. Kontributi në kapitalin themeltar të shoqërisë përbehet nga 2 kuota, me vlerë nominale 500'000 Leke, i depozituar sipas ligjit dhe i zotëruar nga:

- a) Ortaku **Znj. Klodiana Krali** e cila zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 400'000 leke.
- b) Ortaku **Z. Ilia Damos** i cili zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 100'000 leke.

7.2 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht nga Ortaket.

7.3 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të transferohen vetëm në bazë të vendimit unanim të Asamblesë së Përgjithshme për këtë çështje.

NENI 8

ÇERTIFIKATA E KUOTËS

8.1 Ortaket kanë të drejtë të marrin një certifikatë për kuotën që ata kanë. Kjo certifikatë nuk duhet të konsiderohet si sigurim dhe nuk mund t'a shesën apo t'a tregojnë në bursë.



NENI 9 TRANSFERIMI I KUOTAVE

9.1 Kuotat mund t'i transferohen një pale të tretë, që nuk i përket Shoqërisë në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për këtë çështje dhe nëse ky transferim bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Statut.

9.2 Cdo transferim i kryer ndaj një personi i cili nuk është ortak në Shoqëri do të lejohet vetëm nëse më parë i është dhënë e drejta ortakut të mbetur të Shoqërisë të blejë një pjesë apo të gjithë kuotën që shitet.

9.3 Cdo transferim i kuotave i kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij Statuti do të konsiderohet nul dhe i pavlefshëm, dhe do të përbëjë shkelje të detyrave të lëna në mirëbesim nga ortaku shkelës, i cili do të mbajë përgjegjësi në përputhje me Ligjin e Shoqërive.

NENI 10

Zmadhimi dhe Zvogelimi i kapitalit

10.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit. Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet më shumë se kufijtë e përcaktuar nga ligji.

NENI 11

11.1 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregëtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Statuti dhe Akt Themelimi të saj.

KREU III QEVERISJA E SHOQËRISË

NENI 12 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

12.1 Asambleja e Përgjithshme përfaqëson organin vendimmarrës të Shoqërisë.



12.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, për të dhënë mendimin e tij si dhe për të ushtruar të drejtën e votës në proporcion me pjesëmarrjen në kapital.

12.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet në mbledhje nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, me anë të një prokure të posaçme ose të një autorizimi të shkruar. Ortakët nuk mund të përfaqësohen nga Administratori i Shoqërisë.

12.4 Ortakët mund të mos japë të drejtën e votës për pjesën e kuotës që ato kanë për të ushtruar në lidhje më pjesën tjetër.

12.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda vendit apo jashtë shtetit. Ortakët mund të marrin pjesë në këtë mbledhje vetë personalisht ose nëpërmjet mjeteve elektronike si p.sh. video ose konferencë telefonike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të pranishëm dhe të ndjekin në kohë të gjithë diskutimin. Ortaku që merr pjesë nëpërmjet një video konference apo mjeteve të tjera elektronike, mund të votojë nëpërmjet një numri PIN, i cili duhet të komunikohet së bashku me thirrjen për Asamblenë e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme, do të konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllimin e drejtimit të mbledhjes dhe të hartimit të procesverbalit të mbledhjes në regjistrin përkatës.

12.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/Këshilli i Administrimit ose nga ortaku (ët) që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret me anë të një njoftimi të dërguar më postë të regjistruar me lajmërim marrje apo me e-mail (me kushtin që këto njoftime nuk do të konsiderohen të vlefshme nëse nuk ju janë dërguar të gjithë ortakëve në adresat e dhëna Shoqërisë nëpërmjet postës elektronike), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së parashikuar. Thirrja për mbledhje duhet të përmbajë çështjet e rendit të ditës, vendin e mbledhjes, ditën dhe orën e mbledhjes për thirrjen e parë dhe të dytë.

12.7 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur rregullisht, pa patur parasysh formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në të dhe bien dakort për rendin e ditës.

12.8 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë në formë të shkruar dhe të firmosen nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Me kërkesë të ortakëve, vendimi do të përmbajë çdo deklaratë të tyre.



12.9 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

12.10 Asambleja e Përgjithshme, në rast se votimi kërkon një shumicë të thjeshtë votash, ai është i vlefshëm kur votojnë ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë përlind) të kapitalit të Shoqërisë, personalisht ose me përfaqësim. Nëse nuk arrihet një kuorum i tillë, Asambleja e Përgjithshme mbledhet me një thirrje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga thirrja e parë.

12.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar të votave, merr vendime me shumicën e 3/4 të votave vetëm në rast se marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, për çështjet që vijnë: (i) ndryshimi i këtij Statuti; (ii) zmadhim ose zvogëlim të kapitalit themeltar; (iii) shpërndarjen e fitimeve; (iv) riorganizimin ose likuidimin e Shoqërisë.

12.12 Në rast se Shoqëria konsiston në një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, do të kryhen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e ortakut të vetëm do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë, të dhënat të cilat mund të shtohen apo fshihen. Çdo vendim i paregjistruar në regjistrin e vendimeve të shoqërisë është nul.


12.13 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 13

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

13.1 Ortakët i ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me ligjin dhe statutin, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit, Aktin e Themelimit dhe Statutin;
- të kërkojnë dhe të marrin të dhëna që lidhen me situatën dhe aktivitetin e shoqërisë dhe të marrin çdo dokument të hartuar nga Shoqëria (pasqyra financiare, libra llogarie etj.);

- 
- të paraqesin propozime dhe kërkesa të shkruara në Asamblenë e Përgjithshme dhe organe të tjera të Shoqërisë;
 - të drejta të tjera të dhëna nga ligji dhe akti i themelimit.

13.2 Detyrimet e ortakëve janë si vijon:

- të paguajnë tërësisht kuotat e tyre të nënshkruara dhe çdo kuotë shtesë, në përputhje me këtë Statut dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të themeluara në bazë të aktit të themelimit;
- të kryejë detyrimet që i janë caktuar nga organet e Shoqërisë për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

NENI 14 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

14.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (nje) Administrator të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Administratori mund të rizgjidhet dhe të lirohet nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë.

14.2 Administratorit i është dhënë fuqi e plotë lidhur me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë gjithë veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, përveç detyrave të parashikuara nga ligji ose që ligji ja atribuon Asamblesë së Përgjithshme.

14.3 Administratori është përgjegjës për çdo veprim të kryer gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori mund t'i japin palëve të treta fuqi për të kryer veprime të caktuara, që lidhen me administrimin e Shoqërisë.

14.4 Në çdo rast, Administratori duhet të veprojnë në interesin më të mirë të Shoqërisë.

NENI 15

Administrimi

15.1 Administratori i shoqërisë "DAMOS" shpk është si me poshte:


-Z. ILIA DAMOS shtetas Shqiptar i biri i Vangjel lindur me 09/01/1947 ne Greqi, dhe banues ne L9 Rr.Kiço Greço; Nd. P.32; H. H.3; Ap. Ap.31; Korce; 7001, Shqiperi,





identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. 035741267, leshuar ne date 30.01.2020 e vlefshme deri me date 29.01.2030.

15.2 Specimeni i nënshkrimit të Administratorit të parë **Z. Ilia Damos** tregohet më poshtë:

Ilia Damos 

NENI 16 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE

16.1 Pagesat e Administratorit përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 17 LARGIMI I ADMINISTRATORIT


17.1 Detyra e Administratorit përfundon në rastet vijuese:

- (a) sipas parashikimit të ligjit;
- (b) kur ka paaftësi paguese;
- (c) është apo mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- (d) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar për këtë Shoqërinë;
- (e) është zhdukur nga zyra pa dhënë arsye për më shumë se 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm dhe Asambleja e Përgjithshme vendos për largimin nga detyra;
- (f) kur përfundon mandati i tij dhe Asambleja e Përgjithshme nuk e riemëron atë..

KREU IV AUDITIMI FINANCIAR I SHOQERISE VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, DIVIDENDI

NENI 18 AUDITI FINANCIAR





18.1 Auditimi Financiar i Shoqërisë, nëse do të përmbushen kushtet ligjore, do të kryhet nga Auditues Ligjorë, sipas ligjeve Shqiptare në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një ose më shume Auditues Ligjorë.

NENI 19 VITI FINANCIAR

19.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 20 PASQYRAT FINANCIARE

20.1 Bilanci vjetor, tre apo gjashtë mujor, pasqyrat financiare, inventari dhe raportet e Administratorit/Këshillit të Administrimit si dhe Ekspertëve Kontabël, paraqiten në Asamblenë e Përgjithshme për pranim dhe miratim.

20.2 Dokumentet në lidhje me vitin financiar, duhet te miratohen Brenda 6 (gjashte) muajve nga mbarimi I vitit financiar.

NENI 21 DIVIDENDI

21.1 Pas miratimit të Pasqyrave Financiare Vjetore apo periodike (si 3 apo 6 mujore), Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për shpërndarjen e dividendit tek ortakut i Shoqërisë.

NENI 22 SHPËRNDARJA E FITIMIT NË KAPITALIN E SHOQËRISË

22.1 Administratori/Këshilli i Administrimit me marrjen e vendimit me shumicë të Asamblesë së Përgjithshme dhe duke marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në Nenin 14 te Ligjit N. 9901 të datës 14.04.2008 Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, mund të vendosë që fitimet e pashpërndara ortakëve dhe që nuk kanë ndërmend të shpërndahen si dividend preferencial, apo për ndonjë shumë tjetër si fond rezervë i Shoqërisë, të alokohen në kapitalin e Shoqërisë.





KREU V
RIORGANIZIMI, LIKUIDIMI, LIGJI NË FUQI DHE
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 23
RIORGANIZIMI DHE LIKUIDIMI

23.1 Në rastin e riorganizimit ose likuidimit, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për riorganizimin apo likuidimin e Shoqërisë me një shumicë prej 3/4 e votave të ortakeve të pranishëm në mbledhje. Asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht, nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të drejtës së votave në total.

NENI 24
LIGJI NË FUQI

24.1 Shoqëria do të kryej aktivitetet e saj në përputhje të plotë me dispozitat këtij Statuti dhe ligjin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut, do të zbatohet ligji shqiptar në fuqi.

NENI 25
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

25.1 Çdo mosmarrëveshje midis Shoqërisë dhe ortakut të saj, ose mes ortakut dhe trashëgimtarit, ose ndërmjet tyre dhe/ose Shoqërisë, do të zgjidhet miqësisht midis palëve. Nëse një zgjidhje e tillë dështon, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 26
DISPOZITA TË FUNDIT

26.1 Statuti u hartua në 3 kopje në gjuhën shqipe, u lexua, pranua dhe nënshkrua nga Ortaket më 28/07/2023.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "Damos" SHPK

Znj. Klodiana Krali

Z. Ilia Damos

 Klodiana Krali

 ILIA DAMOS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORÇË
NOTER ALKETA A. MULLA



DATE 27/07/2023
NR REP 1280

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më 27/Korik/2023, ditën e enjte para meje Notere Alketa.A. MULLA anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Korçë, me zyrë në adresën Bilisht, NR.2, FUAT BABANI NR.2, NR.18, Lejë Nr. 5141 të leshuar nga Ministria e Drejtësisë datë 16-10-2000, regjistruar në QKB me Nuis Nr K36306660E, u paraqitën personalisht

NËNSHKRUESIT

Ilia Damos, atësia Vangjel, amësia Eftimi, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në Korçë, me adresë L.9 Rr.Kiço Greço; Nd. P.32; H. H.3; Ap. Ap.31; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 09/01/1947, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035741267 dhe nr. personal E70109048T

Klodiana Krali, atësia Zoifori, amësia Florica, shtetase Shqiptare, lindur në Hoçisht, Korçë dhe banues në DEVOLL, me adresë Satrivacit 02750059; Nd. 53; H. 1; Hoçisht; Hoçisht; 7009; Devoll, lindur më 09/10/1981, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034507555 dhe nr. personal I16009142B

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, STATUT DHE AKT THEMELIMI të shoqërisë "DAMOS" sh.p.k., bashkëlidhur këtij vërtetimi

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 ndryshuar me udhëzimin Nr 23, pika 3-4 datë 07.12.2020, Ministre Znj. Etilda Gjonaj, vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Taksa e pullës prej 200 lek u aplikua dhe zbatohet në këtë veprim noterial, bazuar në nenit 63.pika "dh" të ligjit për Noterinë dhe udhëzimeve të përbashkëta të Ministris së Drejtësisë dhe Ministris së Financave

NOTERE

ALKETA A. MULLA

Alketa Mulla
Arano

